

**AKTI I THEMELIT TË
SHOQËRISË
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA
“Prime BPO”**

Sot më date 02.05.2024 bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar dhe në ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar

- Z. Indrit Bakalli , i biri Agimit lindur më **02.10.1976** në **Tirane** dhe banues në **Tirane** shtetas shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin nr **H61002094F** (në cilësinë e Ortakut të shoqërisë), dhe
- Z. Metin Zdralla i biri i Zyberit, lindur më datë 10.07.1994, në Tirane. dhe banues në Tirane, shtetas shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin.J40710083D , (në cilësinë e Ortakut të shoqërisë),

nënskruajnë aktin e themelimit te mëposhtëm për shoqërinë “Prime BPO” SHPK.

KREU I

**EMRI, FORMA, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA, KOHËZGJATJA DHE KAPITALI
THEMELTAR**

NENI 1

Emri i Shoqërisë dhe Forma

- 1.1. Emri i shoqërisë, në përputhje me kriteret ligjore të ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare si dhe ligjin për Qendren Kombëtare të Regjistrimit, është “ **Prime BPO**”.
- 1.2. Shoqëria, ne aktet dhe dokumentat e saj duhet të përmbajë prapashtesën “SHPK” sipas legjislacionit në fuqi.
- 1.3. Shoqëria “**Prime BPO**” (këtu e në vijim referuar si “**Shoqëria**”) është e themeluar dhe organizuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuara dhe aktiviteti i saj rregullohet nga ky akt themelimi dhe ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.

NENI 2

Objekti i Veprimtarisë

Telemarketing-Call Center, perbrenda (inbound) dhe jashte (outbound), brenda vendit dhe nderkombetare.

Sherbime telemarketingu on line apo jo, te çdo forme dhe tipi, direkt apo indirekt.

Sherbime marketing, sherbimesh apo produktesh duke mos u limituar vetem ne to.

Promocione.

Trajnime profesionale ne te gjitha fushat e mesiperme duke mos u limituar vetem ne to.



Shoqëria kryen çdo aktivitet në raport me objektin e vprimtarisë apo të afte për ta favorizuar atë. Shoqëria zbaton të gjithë ligjet dhe aktet nenligjore të duhuara.

Ajo zbaton standartet me të mira të etikës profesionale.

Shoqëria për të realizuar objektin e saj mund të përdorë me hua ose shpërblim toke, të marre me qira, të blejë dhe të administrojë, magazinë, automjete, pajisje, makineri, për këto lloje aktiviteti, etj.

NENI 3

Selia

- 3.1. Selia e shoqërisë, në përmbushje të aktivitetit të saj tregtar, është në adresën Rruga "Xhoxhi Martini". Vila nr.16, kati 1, ap.2.
- 3.2. Sipas ecurisë së aktivitetit tregtar, Shoqëria mund të vendosë për të ndryshuar selinë e saj. Vendimi për transferimin e selisë është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme.
- 3.3. Asambleja mund të vendosë për celjen e NIPT-ve sekondare të Shoqërisë në Shqipëri, në përputhje me nevojat e Shoqërisë.
- 3.4. Çelja e degëve dhe zyrave të përfaqësimit në qytete të tjera brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të caktohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 5

Kohëzgjatja

- 5.1. Shoqëria do të ekzistojë për një periudhë të pacaktuar.

NENI 6

Kapitali Themeltar dhe Koutat e Shoqërisë

- 6.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 LEK në natyrë.
- 6.2. Kapitali Themeltar i shoqërisë është i organizuar në kuota, me vlerë nominale në proporcion me kontributin e secilit prej ortakëve. Shoqëria organizohet dhe operon me një numër total prej 2 kuotash.
- 6.3. Ortakët e Shoqërisë janë:
 - **Z. Indrit Bakalli**, zotërues i kuotës me vlerë nominale 80 LEK e cila përbën 80% të kapitalit themeltar.
 - **Z. Metin Zdralla** zotërues i kuotës me vlerë nominale 20 LEK, e cila përbën 20% të kapitalit themeltar.

Neni 6

Transferimi i Kapitalit

- 6.1. Kuotat e kapitalit të Shoqërisë dhe të drejtat e detyrimit që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen, apo kalohen nepermjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

Në rast se e drejta e parablerjes nuk është ushtruar dhe realizuar brenda afatit të mësipërm, Ortaku Shitës mund të transferojë kuotat e tij tek pala e tretë por vetëm nëse transferimi është kryer sipas të njëjtave kushte dhe afate të parashikuara në Njoftimin për Shitje.

6.4. Perjashtohen nga kufizimet sipas nenit 6.3, rastet e mëposhtme:

1. Kur Ortaku individ ia transferon/shet kuotat e tij (qoftë edhe nëpërmjet dhurimit):
 - a. familjareve të vet, ku përfshihen fëmijet, fëmijet e femijeve, bashkeshorti, prinderit, vellezerit e motrat.
 - b. çdo subjekti juridik, i cili zotërohet teresisht ose pjesërisht nga vete ortaku individ dhe/ose familjarët e vet, të percaktuar sipas perkufizimit të pikës 6.4.1.a.
2. Transferimi ndërmjet ortakëve.

Neni 7

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

- 7.1 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë mund të zmadhohet duke nënshkruar kuota të reja ose duke rritur vlerën nominale të kuotes ekzistues me kontribute në para, në natyrë, nga fitimi dhe nga çdo lloj tjetër kontributi i percaktuar në ligj.
- 7.2 Ortaket kanë të drejtë të nënshkruajnë rritjen e kapitalit, në përputhje me raportin e vlerës nominale të kuotes së secilit Ortak në kapitalin e Shoqërisë.
- 7.3 Mënyra e rritjes së kapitalit (nënshkrimi i kuotave të reja apo zmadhimi i vlerës nominale të kuotave) dhe metodat dhe afatet e pagimit të kontributeve nga ortakët do të vendoset rast pas rasti me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- 7.4 Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet edhe përmes nënshkrimit dhe shlyerjes së kuotave të reja të kapitalit nga ortakët të rinj. Ortakët e rinj do të duhet të pranohen dhe të miratohen si të tillë me një vendim të Asamblesë së Ortakëve me shumicë të cilësuar.
- 7.5 Ortakët mund të financojnë Shoqërinë nëpërmjet financimeve të tjera, si hua me interes ose pa interes, apo në çdo formë tjetër të lejuar nga ligji që është e ndryshme nga zmadhimi i kapitalit, në të cilin rast është i nevojshëm miratimi me shumicë të cilësuar i Asamblesë së Ortakëve.

NENI 8

Zvogëlimi i Kapitalit

- 8.1. Bazuar në vendimet e Asamblesë së Ortakëve, zvogëlimi i kapitalit mund të kryhet në përputhje me të gjitha procedurat e parashikuara nga Ligji nr. 9901 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

KREU II

ORGANET E SHOQËRISË



ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

- 6.2. Transferimi i kuotave të kapitalit tek palët e treta, pjesërisht apo tërësisht, me përjashtim të nenit 6.4, mund të bëhet vetëm me anë të një kontrate shitjeje me shkrim dhe pasi të jenë plotësuar kushtet në nenin 6.3.
- 6.3. Nëse njeri nga Ortakët (“Ortaku Shitës”) ka për qëllim të transferojë kuotën e tij në Shoqëri tërësisht ose pjesërisht, atëherë ky ortak do t’i bëjë me dije me shkrim qëllimin për të shitur Ortakëve të tjerë (“Ortakët Jo-Shitës”) dhe Administratorin/ët e Shoqërisë, së bashku me cmimin e propozuar të shitjes dhe kushtet e pagesës së cmimit. Secili Ortak ka të drejtë të blejë kuotën në shitje me kushtet dhe cmimin e propozuar nga Ortaku Shitës duke njoftuar qëllimin e tij mbi blerjen brenda [30] ditëve nga njoftimi i Ortaku Shitës, tek Ortaku Shitës dhe Administratori i Shoqërisë, me kusht që shitja të realizohet përfundimisht brenda [30 ditëve] të tjera nga mbarimi i afatit të parë për njoftimin e qëllimit të blerjes . Në rast se më shumë se një Ortak Jo-Shitës njofton qëllimin e tij për blerjen e kuotës së Ortakut Shitës, secili prej tyre ka të drejtë të blejë një përqindje të kuotës në shitjes në raport të drejtë me pjesën e tij në kapitalin e Shoqërisë.

Nëse pas ezaurimit të procedurës së mësipërme, Ortakut Shitës merr një ofertë nga një palë e tretë jashtë Ortakëve të Shoqërisë, për blerjen e kuotës me cmimin dhe kushtet e ofruara nga Ortaku Shitës sipas paragrafit të parë të Nenit 6.3, Ortaku Shitës ka të drejtë të realizojë shitjen me këtë palë të tretë pa asnjë kufizim.

Nëse Ortaku Shitës, pas realizimit të procedurës së parashikuar në paragrafin e parë të Nenit 6.3, do të transferojë kuotën e tij në Shoqëri tërësisht ose pjesërisht tek një palë e tretë nga e cila ka marrë një ofertë për blerjen e kuotës me një cmim më të ulët se cmimi i propozuar nga Ortaku Shitës sipas paragrafit të parë të nenit 6.3, atëherë ky Ortak do të njoftojë menjëherë Ortakët Jo-Shitës dhe Administratorin/ët e Shoqërisë, për të gjithë kushtet dhe afatet e transferimit të ardhshëm të kuotave (“Njoftimi për Shitje”), duke përfshirë por pa u kufizuar në: (i) emrin e përfituesit të transferimit, (ii) çmimin që do të paguhet për kuotat, duke përcaktuar nëse çmimi do të paguhet në para apo në natyrë; (iii) mënyrën dhe kushtet e pagesës së cmimit; (iv) një konfirmim me shkrim nga blerësi se oferta ndaj Ortakut Shitës është bërë në mirëbesim (v) garanci bankare për cmimin e blerjes. Ortakët Jo-Shitës mund të ushtrojnë të drejtën e parablerjes mbi kuotën në shitje me anë të njoftimi me shkrim dërguar tek Ortaku Shitës dhe Administratori i Shoqërisë brenda (30) tridhjetë ditëve pune nga dita që kanë marrë njoftimin për shitje (“Njoftimi për Blerje”).

Njoftimi për Blerje duhet në mënyrë të shprehur të përmendë vullnetin e Ortakëve Jo-Shitës për të ushtruar të drejtën e parablerjes mbi kuotën e treguar në Njoftimin për Shitje me të njëjtin çmim, kushte dhe afate siç parashikohet në Njoftimin për Shitje. Në rast se më shumë se një ortak JoShitës ushtron të drejtën e parablerjes, secili prej tyre ka të drejtë të blejë një përqindje të kuotave proporcionalisht me kuotat e zotëruara nga Ortakët Jo-Shitës të cilët kanë ushtruar të drejtën e parablerjes në mënyrën e duhur sipas parashikimeve të mësipërme.



NENI 9

Asambleja e Përgjithshme

- 9.1. Vendimet kryesore të veprimtarisë së Shoqërisë merren me vendim të Asamblesë së Ortakëve, e cila është organi më i lartë i Shoqërisë, që ka të drejtë të miratojë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e aktivitetit të saj.
- 9.2. Ortakët mund të rëndojnë me barrë siguroese apo peng tjetër kuotat e tyre me miratimin paraprak të Asamblesë së Ortakëve, me shumicë të thjeshtë, duke pasur parasysh se ortaku që është i interesuar në vendosjen e barrës siguroese apo peng tjetër mbi kuotat e tij nuk ka të drejtë vote në këtë rast.
- 9.3. Asambleja e Përgjithshme vepron në mbështetje të parashikimeve ligjore dhe dakortësimeve mes ortakëve të shoqërisë dhe është kompetente për çështjet e mëposhtme:
 - 9.3.1. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - 9.3.2. Ndryshimet e Statutit të shoqërisë;
 - 9.3.3. Pranimin e ortakëve të rinj (pas zmadhimit të kapitalit apo transferimit të kuotave);
 - 9.3.4. Zmadhimin dhe/ose Zvogëlimin e kapitalit themeltar;
 - 9.3.5. Vendos mbi blerjen dhe/ose dorëzimin e interesave pjesëmarrëse në shoqëri brenda apo jashtë Shqipërisë;
 - 9.3.6. Të themelojë dhe/ose mbyllë degë dhe përfaqësi jashtë dhe brenda Shqipërisë;
 - 9.3.7. Emërimin dhe shkarkimin e Administratorit/Administratorëve, Likujduesve dhe të Ekspertëve Kontabël të autorizuar;
 - 9.3.8. Përcaktimin e shpërblimeve për Administratorin, Likujduesit dhe Ekspertët Kontabël të autorizuar;
 - 9.3.9. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori apo administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - 9.3.10. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - 9.3.11. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit/administratorëve të shoqërisë;
 - 9.3.12. Blerjen, Bashkimin, Shkrirjen, Transformimin dhe procesin e Likuidimit të shoqërisë;
 - 9.3.13. Emetimi i kuotave;
 - 9.3.14. Përcaktimin e pagës, bonuseve si dhe kohëzgjatjen e emërimit të Administratorit.
 - 9.3.15. Kërkesën drejtuar Administratorit të Shoqërisë për mbarëvajtjen e aktivitetit të Shoqërisë rast pas rasti;
 - 9.3.16. Të depozitojë padi kundër anëtarëve të organeve të Shoqërisë;
 - 9.3.17. Të vendosë mbi përvetësimin, shitjen dhe vendosjen e barrës mbi pasuritë;
 - 9.3.18. Çështje të tjera në ngarkim të Asamblesë nga ligji dhe ky Statut;
 - 9.3.19. Asambleja e Përgjithshme vlerëson dhe vendos për çështjet e parashikuara në nenin 17 të ligjit për shoqëritë tregtare (ndalimi i konkurrencës) rast pas rasti.
- 9.4. Çdo kuotë garanton të drejtën e votës në asamblenë e përgjithshme të ortakëve (“**Asambleja e Përgjithshme**”) në përputhje me përqindjet e parashikuara në Nenin 12.1 të këtij Statuti, të drejtën për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur në organet drejtuese , të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimit të Shoqërisë në përputhje me Nenin 17.4 si dhe të drejtat e tjera të siguruara nga ky Statut, marrëveshjet midis ortakëve dhe parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.



NENI 10

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

- 10.1. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori nëpërmjet njoftimit me postë, njoftimit me postë elektronike ose me çdo mënyrë tjetër që mund të përcillet informacioni, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë. Njoftimi për ortakët duhet të përcaktojë datën, orën dhe vendin e mbledhjes së asamblesë si dhe çështjet për t'u diskutuar (rendi i ditës) dhe, në rast të një asambleje të zakonshme të ortakëve, duhet të përfshijë pasqyrat e plota financiare dhe raportin e administrimit.
- 10.2. Asambleja e Ortakëve do të thirret nga Administratori i Shoqërisë të paktën një herë në vit në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të përcaktuar në njoftim brenda gjashtë muajve të parë të çdo viti kalendarik për të miratuar pasqyrat financiare të Shoqërisë të vitit të mëparshëm financiar.
- 10.3. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas mënyrës së parashikuar më sipër, vendimet e Asamblesë konsiderohen të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
- 10.4. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi (vetëm për atë mbledhje) nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.
- 10.5. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga Administratori i shoqërisë duke përcaktuar rendin e ditës sipas nevojave dhe interesave të shoqërisë, të paktën 1 herë në vit.
- 10.6. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- 10.7. Asambleja e Përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 10.8. Asambleja e Përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para të regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 10.9. Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të votave të përgjithshme të Shoqërisë mund t'i kërkojnë administratorit me shkrim, duke përfshirë postën elektronike, thirrjen e asamblesë së ortakëve. Kërkesa duhet të mbajë arsyet dhe objektivat dhe çështjet për të cilat asambleja e ortakëve duhet të vendosë. Administratori është i detyruar të mbledhë Asamblenë e Ortakëve në përputhje me Nenin 84 të Ligjit për Shoqërisë Tregtare, përndryshe ortakët që kanë kërkuar mbledhjen kanë të drejtë ta mbledhin vetë Asamblenë e Ortakëve sipas kërkesave për njoftim të parashikuara në nenin 10.1. Nëse në kundërshtim me këtë dispozitë, Asambleja e Ortakëve nuk mbledhet, të gjithë ortakët që kanë dërguar kërkesën për mbledhjen e Asamblesë kanë të drejtat e parashikuara nga Ligji Tregtar.
- 10.10. Ortakët janë personalisht përgjegjës për njoftimin e të gjithë të dhënave të kontaktit përfshirë por jo vetëm adresën postare, numrin e faksit, adresën e postës elektronike, të Administratori i Shoqërisë dhe gjithashtu të njoftojë Administratorin për çdo ndryshim të njëpasnjëshëm të të dhënave tyre të kontaktit. Njoftimin e ndryshimeve në të dhënat e tyre të kontaktit do të hyjnë në fuqi ditën e pestë kur njoftimi do të konsiderohet të jetë marrë në përputhje me paragrafin më poshtë.



Për shmangien e çdo dyshimi, çdo njoftim ose komunikim tjetër i nevojshëm për tu dhënë në përputhje me këtë Statut, do të jepet me shkrim në gjuhën angleze dhe duhet të dërgohet dhe/ose dorëzohet të paktën në dy prej mënyrave të mëposhtme, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Statut:

- Dorëzohet dorazi; ose
- Dërgohet me faks; ose
- Dërgohet me postë elektronike; ose
- Dërgohet me postë rekomande; ose
- Nëse njoftimit do të dërgohet me postë jashtë vendit nga i cili dërgohet, do të dërgohet me postë ajrore rekomande.

Adresa e Administratorit do të konsiderohet selia e Shoqërisë por Administratori është gjithashtu i detyruar të japë informacion të kontaktit të tij/saj personal (dhe çdo ndryshimi të mëpasshëm të tij) tek të gjithë ortakët.

NENI 11

Kuorumi dhe Vendimarrja në Asamblenë e Përgjithshme

- 11.1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme 50 për qind plus 1, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 përqind e kuotave.
- 11.2. Për çështjet që kërkojnë shumicë të cilësuar sipas ligjit si ndryshimi i statutit, zmadhimi ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, asambleja vendos me tri të katërtat e ortakëve pjesëmarrës vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.
- 11.3. Vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në këtë statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.
- 11.4. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal, të mbajtura nga Administratori i shoqërisë. Procesverbali përmban datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
- 11.5. Nëse Asambleja e Ortakëve është e mbledhur në mënyrë korrekte, por numri i kërkuar i ortakëve për të plotësuar kuorumin nuk është prezent apo nuk është i përfaqësuar, asambleja e ortakëve do të mbledhet sërish në përputhje me parashikimet e Nenit 10 por jo më vonë se 30 ditë. Rendi i ditës i asamblesë së dytë nuk do të ndryshojë.

NENI 12

E drejta e votës dhe çështje të lidhura me të

- 12.1. Çdo ortak i shoqërisë ka të drejtën e votës në Asamblenë e Përgjithshme, sipas përqindjeve të mëposhtme të cilat nuk janë në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së secilit ortak në kapitalin e Shoqërisë:



- Ortaku i shoqërisë, Z. Indrit Bakalli zotërues i kuotës me vlerë nominale 80 Lekë , zotëron **80 përqind** të së drejtës së votës në shoqëri.
 - Ortaku i shoqërisë, Z.Matin Zdralla, zotërues i kuotës me vlerë nominale 20 Lekë zotëron **20 për qind** të së drejtës së votës në shoqëri.
- 12.2 Të drejtat e votës në përputhje me ndarjet e mësipërme do të reflektohen në ekstraktin e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit përsa kohë është e mundur.
- 12.3 Ortaku përjashtohet nga e drejta e votës vetëm në rastet kur asambleja voton mbi:
- a. Vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b. Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c. Ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d. Dhënien ose jo të përfitimeve të reja;
 - e. Situata të tjera të parashikuara me ligj.
- 12.2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

NENI 13


Administratori

- 13.1. Shoqëria tregtare “Prime BPO” Shpk do të përfaqësohet në marrëdhënie me të tretët nga administratori i saj, i cili vepron në cilësinë e përfaqësuesit ligjor, në përputhje me këtë statut dhe ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
- 13.2. Administrator i shoqërisë “Prime BPO” sh.p.k. emërohet Z. Indrit Bakalli, i biri i Agimit ,lindur më 02.10.1976, në Tirane dhe banues në Tirane, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me mjet identifikimi Pasaportë me Nr. H61002094F për një periudhë 5 vjecare.
- 13.3 Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të jetë administrator i një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- 13.4 Administratori kryen detyrat e tij në përputhje me parashikimet ligjore të detyrimit të besnikërisë sipas neneve 12 (Përfaqësimi), 14 (Besnikëri ndaj shoqërisë), 15 (Informimi për ortakët e shoqërisë sipas parashikimeve ligjore), 17 (Ndalimi i Konkurrencës) e 18 (Sekreti Tregtar) të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 13.5 Shoqëria mund të emërojë më tepër se 1 (një) Administrator. Detyrat dhe përgjegjësitë e parashikuara në këtë statut dhe në ligj, do të ushtrohen bashkërisht nga Administratorët, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 15

Detyrat dhe përgjegjësitë e Administratorit

- 15.1. Administratori i shoqërisë është përgjegjës për:
- a) Manaxhimin e veprimtarisë së biznesit me implementimin e politikave të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme;
 - b) Përfaqësimin e shoqërisë tregtare;




- c) Celjen e llogarive bankare të Shoqërisë në banka;
 - d) Nënshkrimin e të gjithë dokumenteve, lëshimin e faturave, pagmin e detyrimeve të Shoqërisë;
 - e) Kujdesjen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - f) Përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin vjetor të performancës së shoqërisë. Paraqitjen e dokumenteve në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme për miratim së bashku me propozimin dhe shpërndarjen e fitimeve;
 - g) Krijimin e një sistemi paralajmërues për zhvillimet që mund të çënojnë shoqërinë;
 - h) Raportimin në Asamblenë e Përgjithshme mbi implementimin e politikave të të bërit biznes dhe realizimin e transaksioneve me rëndësi të vecantë për performancën e shoqërisë;
 - i) të thërrasë Asamblenë e Ortakëve, kurdo që e konsideron të nevojshëm për interesat e Shoqërisë dhe të ndërmarrë të gjitha formalitetet për thirrjen e rregullt të mbledhjes;
 - j) punësimin dhe shkarkimi e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
 - k) marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, ngritjen e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratorët mund të udhëzojnë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojnë shumën e shpërblimit të tyre dhe do të kenë të drejtë të depozitojnë padi apo t'i tërheqin ato, të nënshkruajnë marrëveshje me gjykatën;
 - l) ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të tjera që i takojnë aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
 - m) thirrjen e mbledhjeve të Ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së Ortakëve për shpalljen e vendimeve përkatëse
 - n) Kryerjen e detyrave të parashikuara nga ligji ose Statuti.
- 15.2. Administratori mund të lidhë kontrata apo të hyjë në marrëdhënie të tjera tregtare me shoqërinë, nëse deklaron kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektin e interesit të tij e veprimi autorizohet paraprakisht nga të gjithë ortakët e shoqërisë. Çdo miratim paraprak dhe i përgjithshëm njoftohet për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 15.3. Administratori mund të autorizojë palë të treta për kryerjen e veprimeve të ndryshme, të tilla si: depozitimin e Pasqyrave Financiare në Qendrën Kombëtare të Biznesit, përfaqësimin e shoqërisë para institucioneve shtetërore etj., përpara organeve gjyqësore, përvec rasteve të parashikuara si kompetencë ekskluzive e Administratorit nga ligji ose ky Statut.
- 15.4. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimit të shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.
- 15.5. Administratori i shoqërisë i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e tij, të parashikuara në këtë statut apo në ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, me profesionalizëm dhe mënjanon në çdo rast konfliktin e interesit në procesin e administrimit të shoqërisë.

15.6. Në ushtrimin e detyrës së tij, administratori udhëhiqet në interes të lartë të shoqërisë edhe në rastet kur një ortak i shoqërisë kërkon ndryshe, qoftë ky ortak në shumicë apo në pakicë.

KREU III

EKSPERTI KONTABËL, DIVIDENDI, PRISHJA, LIKUIDIMI, TË NDRYSHME

NENI 16

Eksperti(ët) Kontabël të Autorizuar

16.1. Eksperti(ët) Kontabël i Autorizuar do të emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, nëse është e nevojshme; Eksperti(ët) Kontabël të autorizuar do të kryejnë detyrat e tyre në përputhje me normat ligje në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 17

Dividendët dhe Fitimi

17.1. Fitimi i shoqërisë përcaktohet në bazë të bilancit të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të zakonshme.

17.2. Shpërndarja e fitimit do të miratohet nga Asambleja në përputhje me Statutin dhe ligjet e zbatueshme. Në baze të ligjit, Asambleja e Përgjithshme do të miratojë në cdo rast shpërndarjen e fitimit tek Ortakët në masën që pas kësaj shpërndarje:

- (a) Aktivitetet e Shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e kësaj të fundit;
- (b) Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet ndaj të tretëve që bëhen të kërkueshme, brenda që muajve të ardhshëm;
- (c) Shoqëria ka rezerva të mjaftueshme për të kryer investimet e miratuara nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të zakonshme.

17.3. Administratori i Përgjithshëm lëshon një Certifikatë të Aftësisë Pague, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikën 17.2 (a) dhe (b) të këtij Statuti.

17.4. Pavarësisht pjesëmarrjes së cdo ortaku në kapitalin e Shoqërisë dhe/ose të drejtave të votës në përputhje me Nenin 12.1 të këtij Statuti, fitimi i miratuar për shpërndarje nga Asambleja e Përgjithshme, do të shpërndahet tek ortakët në raport me përqindjet e mëposhtme:

Z. Indrit Bakalli 80%
Zmetin Zdralla –20%.

NENI 18

Viti Financiar

18.1. Viti Financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.



NENI 19

Bilanci dhe Mbajtja e Llogarisë

- 19.1. Bilanci i Shoqërisë kontrollohet nga Asambleja e Ortakëve dhe duhet të përgatitet për t'ju paraqitur organeve tatimore përpara përfundimit të muajit mars të vitit pasues.
- 19.2. Librat e llogarisë duhet të mbahen në gjuhën shqipe dhe në monedhën vendase (Lekë). Shoqëria mund të mbajë llogari të veçanta në monedhë të huaj, shuma e të cilave duhet të konvertohet, çdo muaj, në monedhën vendase.

NENI 20

Prishja e Shoqërisë

- 20.1. Shoqëria mbaron me vendim të Asamblesë së Përgjithshme; me celjen e procedurës së falimentimit; nëse nuk ka kryer veprimtari biznesi për 2 (dy) vjet dhe nuk ka njoftuar më parë statusin inaktiv sipas ligjit "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit"; ose me vendim gjyqësor.
- 20.2. Administratori ose çdo person i autorizuar prej tij do të depozitojë raportin e mbarimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me ligjin 9723 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar.

NENI 21


Likuidimi

- 21.1. Pas vendimit për mbarimin e shoqërisë, do të çelet procedura e likuidimit, përveç rasteve kur ka filluar një procedurë falimentimi.
- 21.2. Për kryerjen e procesit të likuidimit, Asambleja e Përgjithshme emëron 1(një) ose disa likuidator, për qëllim hartimin e raportit të aktiveve dhe detyrimeve të shoqërisë, deri në mbarim të procesit të likuidimit.
- 21.3. Proçesi i likuidimit do të bëhet në përputhje me ligjin 9901 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.
- 21.4. Pas pagesës së likuidatorëve, kapitali i mbetur i shoqërisë do t'i shpërndahet Ortakëve të Shoqërisë.

NENI 22

Të ndryshme

- 22.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.
- 22.2. Të gjitha situatat që nuk parashikohen nga ky Statut do të rregullohen nga ligji shqiptar Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.
- 22.3. Ky statut është i draftuar në 4 (katër) kopje origjinale me fuqi të njëjtë juridike.



22.4. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.


“Prime BPO” SHPK

Z. Indrit Bakalli

Z. Metin Zdralla

INDRIT BAKALLI

(nënshkrimi)



Metin Zdralla

(nënshkrimi)

